



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1401 / Prot.  
3

Tiranë, më 20/11/2020

**V E N D I M (QARKULLUES)**

Nr. 28 datë 20.11.2020

**PËR**

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN/RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË  
STUDIMIT TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE  
DHE FAKULTETIN E INXHINIERISË ELEKTRIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programi të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 4, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 6, nr. 7 dhe nr. 8, datë 29.09.2020 të Senatit Akademik, si dhe mbështetur në relacionin nr. 1401 prot, datë 17.11.2020 të Administratorit të Institucionit;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit të Doktoratës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Mekanikës, në fushën “Konstruksionet mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor”.
2. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit të Doktoratës në Inxhinieri Elektike, Profili Automatizimi i Industrisë, pranë Departamentit të Automatikës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.